



## Periodiku AMF

### Zhvillohet seminari, ushtrim stimulues krize për Shqipërinë

Gjatë periudhës 31 gusht – 1 shtator, vendimmarrës të nivelit të lartë nga katër autoritete (Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave) morën pjesë në një ushtrim simulues krize për Shqipërinë, organizuar nga Banka Botërore.

*Vijon në faqen 2*

### Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

#### Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - korrik 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - korrik 2010 arritën shifrën 4,820,533 mijë lekë, përkundrejt 4,774,486 mijë lekë të realizuara në janar - korrik 2009 ose 0.96% më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 49.16% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 50.84% të tregut.

*Vijon në faqen 2*

### Ngjarje dhe zhvillime të tjera

#### IAIS nis hartimin e kuadrit të përbashkët për mbikëqyrjen e grupimeve të shoqërive të sigurimit me aktivitet në nivel ndërkombëtar “ComFrame”

*(Material i përpunuar, nxjerrë nga Shoqata Ndërkombëtareve e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS), korrik 2010)*

IAIS do të nisë hartimin e kuadrit të përbashkët për mbikëqyrjen e grupimeve të

shoqërive të sigurimit me aktivitet në nivel ndërkombëtar (ose, shkurt, “ComFrame”) Ky vendim i Komitetit Ekzekutiv vjen pas miratimit në janar të këtij viti të planit të përgjithshëm të projektit, duke përfshirë edhe fazën planifikuese të mëpasshme. Planet dhe skicat e “ComFrame” janë hartuar nga një grup i posaçëm pune, drejtuar nga Autoriteti Zviceran i Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare (FINMA), i cili do të vijojë ta drejtojë çuarjen përpara të këtij projekti.

*Vijon në faqen 5*

### Edukimi i konsumatorit

#### Përparësitë e një standardi global për aftësinë paguese

*(Material i përpunuar, nxjerrë nga Geneva Papers, Vol. 35, nr. 1, 2010)*

*Vijon nga numri i kaluar...*

### Përmbledhje

Krahasimi i rregullimit në SHBA me qasjen e Solvency II të ardhshme në Bashkimin Evropian, tregon se kjo e fundit është, më e përshtatshme për përmbushjen e kërkesave të një standardi të ardhshëm global të aftësisë paguese, i cili të ofrojë përfitimet e shpjeguara më parë në këtë pjesë. Në SHBA, edhe pse disa zhvillime dhe nisma po shkojnë në drejtimin e duhur, qasja mbikëqyrëse e paraqitur nga NAIC nuk i përmbush të gjitha kërkesat e një kuadri të tillë. Megjithatë, disa prej çështjeve që nuk janë zgjidhur, janë përfshirë në planet për t'u studiuar më tej në Nismën e NAIC për Modernizimin e Kërkesave të Aftësisë Paguese.

*Vijon në faqen 7*

## Në këtë numër:

Zhvillohet seminari, ushtrim stimulues krize për Shqipërinë **2**

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura **2**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera **5**

Edukimi i konsumatorit **7**

## Zhvillohet seminari, ushtrim stimules krize për Shqipërinë

Gjatë periudhës 31 gusht – 1 shtator, vendimmarrës të nivelit të lartë nga katër autoritete (Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave) morën pjesë në një ushtrim simulues krize për Shqipërinë, organizuar nga Banka Botërore.

Gjatë menaxhimit të krizës financiare, një sfidë kryesore për autoritetet shtetërore është si t'u përgjigjen në një mënyrë të bashkërenduar dhe të efektshme tronditjeve që mund të kenë një efekt negativ të ndjeshëm në sistemin financiar dhe ekonominë reale.

Ushtrimet e simulimit të krizës ishin një mjet për të testuar se sa i fortë është kuadri organizativ për këtë ngjarje në një mjedis të kontrolluar. Këto ushtrime i dhanë mundësi stafit të lartë të katër autoriteteve, që kanë përgjegjësinë parësore për të siguruar stabilitetin financiar në Shqipëri, të testojnë bashkërendimin midis agjencive (edhe në lidhje me ndarjen e informacionit, vlerësimin, vendimmarrjen) dhe mjaftueshmëritë e masave të mund të merren në kuadër të ekzistencës të politikave për t'u dhënë zgjidhje problemeve të identifikuara. Ky ushtrim ndihmoi autoritetet pjesëmarrëse për të identifikuar dhe vendosur prioritete mes fushave ku duhet më shumë investim.

Seminari mbylli dhe fazën e dytë të programit të asistencës teknike FIRST/IBRD, të hartuar për t'i ndihmuar autoritetet t'i shqyrtojnë, vlerësojnë dhe fuqizojnë masat e tyre ekzistuese organizative për t'u dhënë përgjigje ngjarjeve të mundshme që mund të ndikojnë në stabilitetin financiar të sistemit. Gjatë fazës së parë, është kryer një shqyrtim i plotë i masave ekzistuese, me fokus të veçantë bashkërendimin ndërdepartimental, duke përfshirë edhe sigurimin e një projektplani për krizat dhe mjaftueshmëritë e kompetencave

ligjore, si dhe për t'u marrë me bankat problematike. Më pas, Banka e Shqipërisë nxori një projektmarrëveshje bashkëpunimi, në të cilën parashtrihen përgjegjësitë e secilit prej autoriteteve dhe një qasje e sugjeruar, për të siguruar një reagim të bashkërenduar dhe të efektshëm.

Në përfundim u dha një mundësi e vlefshme për katër autoritetet pjesëmarrëse, në mënyrë që të njihen më shumë me projektmarrëveshjen dhe ta shqyrtojnë atë përpara se ta nënshkruajnë zyrtarisht.

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

### Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - korrik 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - korrik 2010 arritën shifrën 4,820,533 mijë lekë, përkundrajt 4,774,486 mijë lekë të realizuara në janar - korrik 2009 ose 0.96% më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 49.16% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 50.84% të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 14.56% të sigurimeve të Jetës dhe një ulje 0.93% të sigurimeve të Jo-Jetës. 89.43% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 9.78% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës dhe 0.79% nga veprimtaria e risigurimit.

Gjatë periudhës janar - korrik 2010 u nënshkruan rreth 379,459 kontrata sigurimi, ose rreth 14.65% më pak se në janar - korrik të vitit 2009.


### Sigurimet e detyrueshme

Gjatë periudhës janar - korrik 2010, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 58.22% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

**Struktura e tregut të sigurimeve,  
janar-korrik 2010**




**Struktura e tregut të sigurimeve,  
janar-korrik 2010**



**Volumi i primit të shkruar bruto, janar-korrik (2009-2010)**

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2009	2010
<b>Janar - Korrik</b>		
A) Sigurim i Jetës	411,503	471,400
B) Sigurim i Jo-Jetës	4,351,580	4,311,205
a) Sigurimi Detyrueshëm	2,552,302	2,450,840
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	1,799,278	1,860,365
c) Risigurimi	11,403	37,928
<b>TOTAL</b>	<b>4,774,486</b>	<b>4,820,533</b>

**Volumi i primit të shkruar bruto,  
janar-korrik 2010 (Jeta dhe Jo-Jeta)**



Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për periudhën janar - korrik 2010, arritën 1,765,864 mijë lekë, ose 3.93% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2009.

Në janar - korrik 2010, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 797,219 mijë lekë, ose rreth 27.34% më pak se në janar - korrik 2009.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë periudhës janar - korrik 2010 arritën në 187,757 mijë lekë, apo 11.18% më shumë se në janar - korrik 2009.

## Sigurimet vullnetare

Në janar - korrik 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 2,369,694 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), ose 6.64% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.


Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 1,898,293 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 32.41% të pasuara nga, sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 20.80% dhe nga sigurimi kasko me 18.72%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet e garancisë, si dhe prime nga veprimtaria e risigurimit.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar - korrik 2010, arritën në 199,003 mijë lekë, 4.06% më pak se në janar - korrik 2009. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 76.68% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e Jetës në janar - korrik 2010 arritën në rreth 471,400 mijë lekë, ose rreth 9.78% më shumë se në janar - korrik 2009. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

## Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interlbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 30.79% të primeve.



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 54.48 % të primeve.

## Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - korrik 2010 kapi vlerën 1,183,410 mijë lekë, ose 27.39% më shumë se në janar - korrik 2009. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,024,967 mijë lekë, apo 86.61% të totalit.

## Ngjarje dhe zhvillime të tjera

### **IAIS nis hartimin e kuadrit të përbashkët për mbikëqyrjen e grupimeve të shoqërive të sigurimit me aktivitet në nivel ndërkombëtar “ComFrame”**

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Shoqata Ndërkombëtareve e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS), korrik 2010)

IAIS do të nisë hartimin e kuadrit të përbashkët për mbikëqyrjen e grupimeve të shoqërive të sigurimit me aktivitet në nivel ndërkombëtar (ose, shkurt, “ComFrame”) Ky vendim i Komitetit Ekzekutiv vjen pas miratimit në janar të këtij viti të planit të përgjithshëm të projektit, duke përfshirë edhe fazën planifikuese të mëpasshme. Planet dhe skicat e “ComFrame” janë hartuar nga një grup i posaçëm pune, drejtuar nga Autoriteti Zviceran i Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare (FINMA), i cili do të vijojë ta drejtojë çuarjen përpara të këtij projekti.

“ComFrame”:

- **Do të përgatisë metodat e mbikëqyrjes së plotë të grupimeve të shoqërive të sigurimit me aktivitet në nivel ndërkombëtar (IAIG)** për ta bërë më të efektshme mbikëqyrjen e gjithë grupimit dhe më pasqyruese praktikatat faktike tregtare;
- **Do të vendosë një kuadër të plotë që entet mbikëqyrëse të trajtojnë aktivitetet dhe risqet e gjithë grupimit, si edhe do të hedhë bazat për një bashkëpunim më të mirë mbikëqyrës** për të mundësuar një qasje më të integruar dhe më ndërkombëtare;
- **Do të nxisë konvergencën globale** të masave e qasjeve rregullatore dhe mbikëqyrëse.

Sipas Peter Braumüller, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të IAIS-it : “IAIS ka kënaqësinë që, duke filluar nga data 1 korrik 2010, të nisë hartimin e “ComFrame”. Kjo do t’u sigurojë enteve mbikëqyrëse gjuhën dhe strukturën e përbashkët për t’i vlerësuar dhe mbikëqyrur më mirë

shoqëritë e sigurimeve me aktivitet në nivel ndërkombëtar, duke e rritur kështu efikasitetin dhe njëtrajshmërinë e mbikëqyrjes. “ComFrame” është një projekt i rëndësishëm për ne, i cili do ta rrisë nivelin konvergencës rregullatore dhe mbikëqyrëse ndërkombëtare. Futja dhe vënia në zbatim e një qasje koherente, të harmonizuar mirë dhe të vendosur në punë në mënyrë efektive për mbikëqyrjen e këtyre grupimeve, përbën një problem kyç për mbikëqyrësit në mbarë botën”.

### **Realizimi i mbikëqyrjes së plotë të grupimeve të shoqërive të sigurimit me aktivitet në nivel ndërkombëtar**

Nga ana konceptuale, “ComFrame” është një paketë e re dhe e integruar, e cila synon t’u sigurojë mbikëqyrësve mjetet për vlerësimin dhe krahasimin e grupimeve të shoqërive të sigurimit me aktivitet në nivel ndërkombëtar në mbarë botën, përmes një mbikëqyrje më të harmonizuar dhe më të njëtrajtshme, të realizuar nga entet mbikëqyrëse në vendin nisës dhe pritës mbi baza shumëpalëshe.

### **Vendosja e një kuadri të plotë për trajtimin e aktiviteteve dhe risqeve të mbarë grupimit dhe hedhja e bazave për një bashkëpunim më të mirë mbikëqyrës**

“ComFrame” si pjesë e sigurimit të një mënyre veprimi për mbikëqyrjen e grupimeve të shoqërive të sigurimit me aktivitet në nivel ndërkombëtar, do të mbulojë:

- strukturën, paketën dhe zhvillimin e biznesit të grupimit, nga këndvështrimi i administrimit të riskut;
- kërkesat sasiore dhe cilësore, si dhe;
- bashkëpunimin dhe ndërveprimin mbikëqyrës.

“ComFrame” nuk do të merret drejtpërdrejt me riskun e sistemit, në vetvete. Megjithatë, IAIS është i mendimit se, kur të vihet në zbatim dhe në funksionim “ComFrame”, kjo do t’i përmirësojë instrumentet dhe mjetet e enteve mbikëqyrëse

për t'u marrë dhe, aty ku është e mundur, për ta zbutur riskun që mund të prekë siguruesit. Në thelb, "ComFrame" synon të jetë një kuadër i plotë dhe i drejtpeshuar, i cili përqendrohet në mënyrë të barabartë si në elementet *sasiore* ashtu edhe në ato *cilësore*.

### **Nxitja e konvergencës globale**

Përmes punës së saj përgatitore, deri në fillimin e hartimit të kuadrit "ComFrame", IAIS ka pohuar qëndrimin e saj, se ekziston nevoja për një kuadër më të integruar shumëpalësh për mbikëqyrjen e të gjithë grupimit. Mësimet e nxjerra nga kriza e fundit financiare, mes të tjerash, konsiderohet e nevojshme që mbikëqyrësit të trajtojnë boshllëqet rregullatore në mënyrë të harmonizuar dhe jo në mënyrë individuale dhe të izoluar.

IAIS thekson se "ComFrame" nuk synon të jetë një përmbledhje qasjesh tejet përshkruese dhe të përkufizuar në mënyrë të ngushtë. Përkundrazi, "ComFrame" do të jetë e përqendruar te *rezultatet* dhe, edhe pse *nuk është i mbështetur te rregullat*, kërkesat e tij do të shoqërohen nga parametra dhe specifikime konkrete. Kjo mbështetet në konstatimin se parimet mbikëqyrëse që zbatohen nga juridiksione të ndryshme shpesh janë thjesht qasje të ndryshme që arrijnë rezultate të ngjashme. "ComFrame" do të jetë gjithmonë në zhvillim. Nuk do të ketë asnjëherë maksimum të përsosmërisë. IAIS dhe anëtarët e saj do ta përmirësojnë vazhdimisht këtë kuadër për të pasqyruar ndryshimet e rrethanave dhe përvojën e fituar me kalimin e kohës në lidhje me "ComFrame". "ComFrame" do të jetë i shëndoshë dhe do të ketë kuptim si në teori ashtu edhe në praktikë. Do të zhvillohen konsultime të rregullta me ekspertë të këtij sektori të ekonomisë, me ecjen përpara të punës, për të siguruar që qasjet e zhvilluara në kuadër të "ComFrame" të pasqyrojnë praktikën tregtare dhe strukturat e grupimeve të shoqërive tregtare.

"ComFrame" është një projekt i cili është

ndërmarrë me *ndërgjegje* të plotë, por të cilin e ka diktuar edhe *nevoja*. Së pari, dhe mbi të gjitha, ai përbën një përgjigje politike të IAIS-it për ta bërë më të fortë dhe të efektshme mbikëqyrjen e grupimeve të shoqërive të sigurimit me aktivitet në nivel ndërkombëtar. "ComFrame" do t'i sigurojë IAIS-it edhe një bazë më të mirë për t'u marrë dhe për të kontribuar në punën që po realizohet në disa forume ndërkombëtare në përgjigje të krizës më të fundit financiare.

### **Struktura dhe afatet kohore**

"ComFrame" mbështetet në disa module kyçe, të cilat shtjellohen më me hollësi në elementet përkatëse. Është hartuar kjo strukturë për t'i dhënë mundësi kuadrit "ComFrame" të organizojë punët e ndryshme dhe t'i zhvillojë ato më vete, por në mënyrë të bashkërenduar. Brenda mesit të vitit 2011, do të përfundojë një dokument konceptual, në të cilin do të jepet një informacion më i hollësishëm për këtë kuadër.

Secilit element i është dhënë një prioritet i caktuar (A, B ose C), në varësi të afatit të realizimit. Elementet me prioritet A do të jenë gati për konsultim brenda fundit të vitit të parë (1 korrik 2011), elementet me prioritet B do të jenë gati brenda fundit të vitit të dytë (1 korrik 2012), ndërsa elementet me prioritet C do të jenë gati brenda fundit të vitit të tretë (1 korrik 2013). Faza trevjeçare e zhvillimit do të ndiqet nga vlerësimet e efektit, për të realizuar disa prej kalibrimeve dhe parametrave të nevojshëm për disa kërkesa të caktuara. Në lidhjen e këtij materiali, jepet një skicim i modulit, elementeve dhe prioriteteve përkatëse.

### **Konteksti**

Hartimi i "ComFrame" bëhet në kushtet e rritjes së rëndësisë që kanë marrë grupimet e shoqërive të sigurimit, duke përfshirë edhe ato që janë aktive në nivel ndërkombëtar. Kjo kërkon një reagim politik koherent, kuptimplotë dhe të qëndrueshëm nga IAIS, në lidhje me këto



grupime. Këto grupime përfshihen në aktivitete në disa vende dhe tregje dhe synojnë të arrijnë përfitime nga bashkimi i forcave në shumë aspekte, duke përfshirë edhe përmes grumbullimit të risqeve dhe përmes optimizimit të efikasitetit financiar. Kjo mund të përfshijë edhe kalimin e risqeve nga një pjesë e grupimit në një tjetër, shpesh duke i kapërcyer kufijtë kombëtare.

Në dallim nga aktivitetet gjithnjë e më globale të këtyre grupimeve, mbikëqyrja e sigurimeve ka mbetur kryesisht brenda kufijve kombëtare, duke u përqendruar në mbikëqyrjen individuale. Janë hartuar ose po hartohen korniza dhe/ose metoda për mbikëqyrjen e plotë të grupimeve, në një sërë juridiksionesh e rajonesh dhe IAIS është duke i trajtuar gjithnjë e më shumë aspektet e grupimeve në punën e saj. Për shembull, për grupimet e shoqërive të sigurimit, IAIS e ka rritur punën e saj për përmirësimin e mbikëqyrjes së plotë të grupimeve në mbarë botën, pas futjes së një Parimi Qendror të Sigurimit (ICP) për mbikëqyrjen e plotë të grupimeve në vitin 2003. Parimet për Mbikëqyrjen e Grupeve, të nxjerra më pas, hodhën themelet për materialet e publikuara kohët e fundit, udhëzimet për përdorimin e kolegeve mbikëqyrëse në mbikëqyrjen e grupeve, rolin dhe përgjegjësitë e trajtimit të subjekteve të pambikëqyrura në mbikëqyrjen e grupit. Po punohet më tej për të hartuar ose për të përmirësuar materialet mbikëqyrëse për kërkesat rregullatore për të gjithë grupimin, për bashkëpunimin mbikëqyrës, për shkëmbimin e informacionit, për njohjen e mbikëqyrjes, etj. Një material udhëzues i përgjithshëm për kuadrin e mbikëqyrjes së plotë të grupimeve do të shpjegojë lidhjet dhe marrëdhëniet midis komponentëve të ndryshëm të mbikëqyrjes së plotë të grupimeve. Këto materiale mbikëqyrëse do të përbëjnë bazën për hartimin e “ComFrame”.

Megjithatë, ende nuk ka një kuadër koherent në nivel ndërkombëtar. Sa më lart, IAIS shikoi disa prej përpjekjeve për mbikëqyrjen e plotë të

grupimeve në gjithë botën dhe shkëmbeu përvoja të ndryshme me organet anëtare të saj. U ra dakord që ka ende vend për përmirësim lidhur me mënyrën me të cilën anëtarët e IAIS-it i mbikëqyrin grupimet dhe mënyrën me të cilën i administrojnë risqet grupimet, shumë prej të cilave u rritën gjatë krizave financiare të kohëve të fundit dhe më parë. Është parë qartë se mbikëqyrësit kanë nevojë për qasje më të mira, për të kuptuar si janë të organizuara dhe si ushtrojnë aktivitet grupimet e shoqërive të sigurimeve që janë aktive në nivel ndërkombëtar. Po kështu, këto grupime do të përfitonin nga vendosja e një pike referimi, me qëllim rritjen e besimit të mbikëqyrësve të ndryshëm. Është pranuar gjithashtu edhe që vetëm disa anëtarë të IAIS-it janë juridiksionet parësore dërguese, ndërsa një numër i madh i anëtarëve të IAIS-it janë juridiksione pritëse për pjesë të këtyre grupimeve. Një qasje më e mirë e strukturuar për të rritur bashkëpunimin dhe ndarjen e informacionit midis mbikëqyrësve, është jetike për të krijuar një pamje të plotë të grupimit.

## Edukimi i konsumatorit

### **Përparësitë e një standardi global për aftësinë paguese**

*(Material i përpunuar, nxjerrë nga Geneva Papers, Vol. 35, nr. 1, 2010)*

*Vijon nga numri i kaluar...*

### **Përmbledhje**

Krahasimi i rregullimit në SHBA me qasjen e Solvency II të ardhshme në Bashkimin Evropian, tregon se kjo e fundit është, më e përshtatshme për përmbushjen e kërkesave të një standardi të ardhshëm global të aftësisë paguese, i cili të ofrojë përfitimet e shpjeguara më parë në këtë pjesë. Në SHBA, edhe pse disa zhvillime dhe nisma po shkojnë në drejtimin e duhur, qasja mbikëqyrëse e paraqitur nga NAIC nuk i përmbush të gjitha kërkesat e një kuadri të tillë.

Megjithatë, disa prej çështjeve që nuk janë zgjidhur, janë përfshirë në planet për t'u studiuar më tej në Nismën e NAIC për Modernizimin e Kërkesave të Aftësisë Pagueuse.

### **Të metat e mundshme që vijnë nga ndjekja e zgjidhjeve individuale**

Moszbatimi i një standardi global mbikëqyrës mund të kishte efekte të padëshirueshme në tregjet e sigurimeve që po bëhen gjithnjë e më shumë të integruar dhe të ndërlidhur. Në pjesën tjetër të kësaj pike renditen disa prej argumenteve më të dukshme. Ndjekja e zhvillimeve individuale do të krijonte në mënyrë të paevitueshme rregulla loje rregullatore jo të barabarta. Shumë pak mund të arrihet konkurrenca në një situatë barazie të pamjaftueshme rregullatore. Kjo vlen për nivele dhe faza të ndryshme procesi rregullator.

Kërkesa të ndryshme të kapitalit të riskut për të njëjtin risk dhe për të njëjtën vlerë zbulimi janë një zhvillim i padëshirueshëm, që pengojnë konkurrencën e ndershme dhe kanë disavantazhe për mbajtësit e policave. Kjo vlen edhe në lidhje me kriteret e pranueshmërisë për fondet e veta apo për burimet e zmadhimit të kapitalit, të cilat ndikojnë në përbërjen e kapitalit të shoqërive dhe kërkesave për kthimin mbi kapitalin.

Nivele të ndryshme të kërkesave mbikëqyrëse për administrimin e riskut dhe për raportimin mbikëqyrës çojnë në një shpërndarje jo të njëtrajtshme të kostove dhe burimeve. Kjo favorizon shoqëritë që veprojnë në bazë të standardeve mbikëqyrëse me kërkesa ligjore relativisht të ulëta, ndërkohë që krijojnë pengesa për shoqëritë që ushtrojnë aktivitet në regjime më të avancuara me kërkesa më të plota.

Në fund, mungesa e mbikëqyrjes së grupimeve krijon disavantazhe të mëdha për grupimet e shoqërive të sigurimeve dhe risigurimeve që ushtrojnë aktivitet në nivel ndërkombëtar. Grupimet e sigurimeve nuk do të shikoheshin nga

kapaciteti i tyre për ta përdorur kapitalin në mënyrë efçente dhe për të shfrytëzuar përfitimet që sjell diversifikimi rajonal. Në fakt, grupimet duhet ta kapitalizojnë çdo njësi ekonomike sipas kërkesave përkatëse lokale të kapitalit rregullator. Për më tepër, grupimet nuk mund të shfrytëzojnë përparësitë e një krye-mbikëqyrësi që bashkëpunon me një grupim mbikëqyrësish, por duhet të merren veçmas me secilin autoritet rregullator. Një procedurë e tillë sjell kosto më të larta dhe shfrytëzim jo efçent të burimeve.

### **IAIS si autoritet global mbikëqyrës i sigurimeve**

Në rubrikat e mësipërme kemi treguar që krijimi i një standardi global për sigurimet është një sipërmarrje ambicioze por me vlerë. Krahas pasjes së standardeve rregullatore dhe gatishmërisë së shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, mbetet çështja nëse ekziston apo jo një autoritet rregullator me aftësi dhe kompetenca të mjaftueshme dhe adekuate për të siguruar përmbushjen e standardeve globale.

IAIS, i cili përfaqëson entet rregullatore dhe mbikëqyrëse në mbarë botën, duket se është kandidati më i përshtatshëm. Kjo organizatë është ngritur në vitin 1994 dhe objektivi kryesor i saj është publikimi i Parimeve Qendrore të Sigurimeve (ICP), parimeve të tjera dhe standardeve rregullatore. ICP janë parimet themelore për rregullimin dhe marrëdhënien, për shembull, me sistemin mbikëqyrës, kërkesat për mbikëqyrjen e kujdesshme apo çështjet që kanë lidhje me procesin mbikëqyrës të tanishëm. ICP janë pranuar nga anëtarët e IAIS si një standard mbikëqyrës i përshtatshëm, por në realitet shoqërive ende u duhet të përmbushin standardet dhe kërkesat rregullatore lokale. Parimet, Standardet dhe Materialet Orientuese të IAIS, tani për tani, nuk janë detyruese, çka do të thotë se nuk janë të zbatueshme drejtpërdrejt për siguresit dhe risiguresit por duhet të zbatohen nga anëtarët e IAIS.

Edhe pse duket se ka një marrëveshje të





përgjithshme mes grupeve të interesit se duhet fuqizuar IAIS për të arritur një standard global për aftësinë paguese në periudhën afatmesme deri afatgjatë, ka ende paqartësi se si do të mund të përmbushet kjo. Një alternativë do të ishte ristrukturimi i IAIS në një organizatë të ngjashme me OBT, me kompetencën për të nxjerrë udhëzues me efekt detyrues dhe për të zhvilluar procedura të përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, është e konceptueshme që Komiteti i Sigurimeve i OECD mund të luante një rol më të spikatur. Të dy alternativat mund të shikohen më në hollësi.

Megjithatë, shumë besojnë se ideja më premtuese për sigurimet është ndjekja e një procesi të ngjashëm me atë të zhvilluar për Komitetin e Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare. Komiteti i Bazelit është krijuar nga guvernatorët e bankave qendrore të vendeve të G-10 në vitin 1974. Ajo që është interesante, ky Komitet nuk ka asnjë autoritet mbikëqyrës supernacional. Përfundimet e tij nuk kanë asnjë fuqi ligjore, dhe nuk është menduar të kenë një fuqi të tillë. Si IAIS, Komiteti i Bazelit përpilon standarde, udhëzues dhe praktikat më të mira të mbikëqyrjes. Por, zakonisht normat e mbikëqyrjes bankare miratohen nga guvernatorët e bankave qendrore dhe krerët e mbikëqyrjes bankare të vendeve anëtare të G-10, siç është rasti i Marrëveshjes së Bazelit e vitit 1988, Bazeli II i vitit 2004 apo Kuadri i Rishikuar i vitit 2006.

Pa cenuar dy alternativat e para dhe pa u hyrë argumenteve pro dhe kundër për secilën alternativë, kjo qasje e fundit duket se është më e realizueshmja, duke qenë se mund të zbatohet brenda një periudhe të arsyeshme kohe.

### **Përfundim dhe shikim nga e ardhmja**

Duket qartë se qasjet ndërkombëtare në drejtim të rregullimit të përbashkët të sigurimeve janë

një ndërmarrje e rëndësishme. Për rrjedhojë, vendimmarrësit politikë dhe mbikëqyrësit nuk duhet ta humbasin këtë shans, tani, për ta ngritur çështjen e një standardi global për mbikëqyrjen dhe rregullimin e aktivitetit të sigurimit dhe risigurimit. Në Evropë, sidomos, po shihen zhvillime premtuese me planifikimin e vënies në zbatim të regjimit Solvency II brenda fundit të vitit 2012, si edhe në SHBA. Organet mbikëqyrëse në disa vende kanë treguar interes për tiparet e Solvency II dhe disa kanë filluar vënien në zbatim të kërkesave të ngjashme për të siguruar njohjen reciproke të regjimeve mbikëqyrëse (për shembull, Bermuda). Një qasje e re globale duhet të përfshijë, pa tjetër, dy tregjet kryesore, SHBA dhe Bashkimin Evropian. Vetëm atëherë nismat e tanishme mund të zhvillohen në përpjekje globale për të përqafuar një standard mbikëqyrës mbarëbotëror në të cilin shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit u nënshtrohen kushteve dhe kërkesave të ngjashme mbikëqyrëse, pavarësisht se nga vijnë dhe ku planifikojnë të ushtrojnë aktivitetet tregtar. Objektivi duhet të jetë rishikimi i mjedisit të tanishëm mbikëqyrës, i cili nuk është i njëtrajtshëm dhe pengon funksionimin e modeleve tregtare të siguriesve dhe risiguriesve të ushtrojnë aktivitetet në nivel ndërkombëtar. Mungesa e një fushe të njëtrajtshme loje për rregullimin sjell kosto më të larta dhe mungesë të efikasitetit për siguriesit dhe risiguriesit, mbikëqyrësit dhe mbajtësit e policave. IAIS, që ka disa vjet që punon për standardet dhe parimet për një kuadër të ri mbikëqyrës botëror, mund të përbënte një pikënisje të mirë për një autoritet mbikëqyrës të ri dhe të efektshëm.

### ***Për këtë numër punuan:***

E. Shehi, R. Guri, A. Dervishi,  
R. Eltari, E. Kokona

